



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr.2330/14 Prot

Tiranë më 17.12.2018

**VENDIM**

**Nr.37, datë.17.12.2018**

***“Mbi ridërgimin në MASR të Statutit të Universitetit të Tiranës”***

Bazuar në nenin 33, pika 2; në nenin 38, pika 1/c të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, pasi mori në shqyrtim shkresën nr. 9923/1 datë 23.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018,

**VENDOSI:**

1. Të reflektojë në përmbajtjen e Statutit të Universitetit të Tiranës konstatimet e renditura në *gërma A “Të përgjithshme”* të shkresës nr. 9923/1 datë 23.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
2. Të mos reflektojë në përmbajtjen e Statutit të Universitetit të Tiranës konstatimet e renditura në *gërma B “Nen për nen”* të shkresës nr. 9923/1 datë 23.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke ruajtur formulimet nen për nen të Statutit siç janë miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UT nr. 30 datë 14.09.2018 përcjellë në MASR me shkresën nr. 2330/10 prot., datë 26.09.2018.
3. Statuti i Universitetit të Tiranës t’i ridërgohet Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit vetëm me reflektimet sipas konstatimeve *gërma A “Të përgjithshme”* të shkresës nr. 9923/1 datë 23.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF. DR. MYNYR KONI**